



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI PËR PERFORMANCË DHE TRANSPARENCË TË KOMUNAVE DIVIZIONI PËR
PERFORMANCË TË KOMUNAVE

RAPORTI I PERFORMANCES SË KOMUNAVE
2015

Prishtinë, qershor 2016

Përmbajtja

SHKURTESAT	5
1. Përmbledhja ekzekutive.....	5
2. Qëllimi	9
3. Përfituesit.....	9
4. Metodologjia e punës	9
5. Struktura e raportit	9
KAPITULLI II	10
1. Pasqyra e përgjithshme e performancës së komunave.....	10
2. Performanca e komunave sipas fushave përkatëse	13
2.1. Pasqyrimi i të dhënave të raportuara	13
2.1.1. Shërbimet administrative	13
2.1.2. Mirëqenia sociale	14
2.1.3. Kulturë, rini dhe sport.....	16
2.1.4. Menaxhimi i emergjencave lokale	17
2.1.5. Planifikimi urban	20
2.1.6. Parqet dhe sheshet.....	21
2.1.7. Rrugët.....	22
2.1.8. Trotualet	24
2.1.9. Transporti publik komunal	25
2.1.10. Parkingjet publike	27
2.1.11. Ndriçimi publik	30
2.1.12. Furnizimi me ujë	32
2.1.13. Kanalizimi dhe higjiena publike.....	34
2.1.14. Grumbullimi i mbeturinave	37
2.1.15. Deponimi i mbeturinave	39
KAPITULLI IV	41
AZHURITETI	41
4.1. Pasqyra e përgjithshme e azhuritit të komunave.....	41
4.2. Efikasiteti dhe efektiviteti i azhuritit të komunave	43
KAPITULLI V	44
NDIKIMET E PERFORMANCËS DHE AZHURITETIT	44

a.	Ndikimet në funksionimin e sistemit të VQL	44
b.	Ndikimet në punën e komunave	44
c.	Ndikimet në ofrimin cilësor tëshërbimeve	44
SHTOJCA 1:	PASQYRA E TË DHËNAVE INDIVIDUALE TË KOMUNAVE.....	45
SHTOJCA 2:	PASQYRA INDIVIDUALE E TË DHËNAVE PËR AZHURITETIN E KOMUNAVE.....	63
SHTOJCA 3:	PASQYRA INDIVIDUALE E TË DHËNAVE PËR AZHURITETIN E KOMUNAVE.....	65

SHKURTESAT

MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SMPSHK	Sistemi i Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
PL	Pushteti Lokal
DEMOS	Decentralisation and Municipal Support
USAID	Agency for International Development
DEMI	Iniciativa për Komunal Demokratike dhe Efektive
LOGOS	Lokal Governace and Decentralization Support
CSC	Citizens Service Center
CMS	Content Management System
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

KAPITULLI I**1. Përmbledhja ekzekutive**

Komunat janë duke u ofruar lloje të ndryshme të shërbimeve qytetarëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tyre. Ekziston një listë e pritjeve themelore të përcaktuara me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale (LVL) dhe lista e shërbimeve specifike të bazuara në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të komunave përkatëse. Llojet e pritjeve kanë të bëjnë me nevojat e ndryshme të qytetarëve për shërbime, ndërsa performanca e komunave ka të bëjë me matjen e nivelit të ofrimit të këtyre shërbimeve nga komunat. Pritjet e qytetarëve janë përkthyer në kompetenca dhe funksione të komunave për ofrimin e shërbimeve të tyre. Në këtë pikëpamje, komunat ofrojnë tri grupe të mëdha të shërbimeve nga kompetencat vetanake, kompetencat e deleguara dhe kompetencat e zgjeruara.

Aktualisht Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale (SMPSHK) bën matjen e 15 fushave të ndryshme themelore nga kompetencat vetanake të komunave. SMPSHK funksionon dhe siguron matjen e performancës në secilën fushë duke u bazuar në rezultatet dhe treguesit përkatës. Në vitin 2015 janë bërë analiza dhe vlerësime profesionale për problemet e funksionimit të SMPSHK aktual. Është vlerësuar nevoja e rishikimit të sistemit aktual. Procesi i rishikimit ka filluar në nëntor të vitit 2015 dhe do të zgjatë deri në dhjetor të vitit 2016 ndërsa pritet që, raporti i performancës për vitin 2016 sipas SMPSHK të rishikuar, do të botohet në tremujorin e parë të vitit 2017.

Matja e performancës së komunave është zhvilluar nëpërmjet vështirësive dhe mangësive të caktuara profesionale, të përvojës dhe atyre buxhetore. Fillimisht ndërtimi i SMPSHK është bërë nga MAPL në bashkëpunim të ngushtë me USAID. Ndërkaq tani procesi i rishikimit të SMPSHK po ndihmohet nga Qeveria Zviceriane, nëpërmjet projektit DEMOS. Periudha kohore nga muaji janar deri në muajin dhjetor të vitit 2015 për komunat e Republikës së Kosovës paraqet vazhdimësinë e përpjekjeve, sukseseve dhe të arriturve në ofrimin kualitativ të shërbimeve për qytetarët, por edhe të vështirësive me të cilat ballafaqohen komunat në punën e vazhdueshme të tyre.

Pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të Performancës së komunave për vitin 2015 do të jetë edhe Raporti i Azhuritetit dhe i Efikasitetit të Organeve Komunale. Edhe në këtë pjesë të raportit do të shihen të dhënat të cilat tregojnë nivelin e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët. Këto të dhëna janë siguruar nga platforma e përbashkët elektronike CSC/CMS. Të dhënat për pjesën e azhuritetit dhe efikasitetit të organeve komunale, të cilat janë siguruar nga kjo platformë, do të paraqet një sfidë për përdorimin e kësaj platforme të përbashkët elektronike. Megjithatë kjo paraqet një përparësi të madhe për komunat dhe MAPL-në, në kuptimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët, evidentimin e të gjitha transaksioneve të bëra nga ana e komunave dhe njëkohësisht raportimin shumë të lehtë dhe të saktë të këtyre të dhënave. Procesi i menaxhimit të performancës komunale përfshinë në vazhdimësi zhvillimin e kapaciteteve për përdorimin e sistemit menaxhues të performancës së shërbimeve komunale (SMPSHK). Në vitin 2015 janë organizuar katër punëtori me koordinatorët e performancës komunale për ndërtimin e kapaciteteve të tyre për metodologjinë e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave për performancën e komunave.

I tërë procesi i matjes së performancës komunale është i ndarë në dy pjesë apo faza të veçanta, të ndërlidhura ndërmjet veti: (1) mbledhja dhe raportimi i të dhënave për treguesit përkatës të performancës nga komunat dhe (2) përpunimi (analiza) e këtyre të dhënave nga MAPL, mbi

bazën e të cilit nxirren përfundimet për performancën e komunave në ofrimin e shërbimeve që aktualisht maten.

Komunat e Republikës së Kosovës në vitin 2015 kanë arritur një mesatare të performimit të tyre në shkallën prej 44.79%. Megjithëse vlersimi i performancës së komunave në raport paraqitet për të gjitha fushat dhe treguesit, llogaritja e përqindjes së kësaj mesatareje, ka qenë e mundur të bëhet vetëm për treguesit të cilët japin rezultatet në përqindje. Gjithsej 20 tregues, sipas ndërtimit të tyre, nuk kanë njësi të njëjtë matëse dhe si të tilla nuk japin mundësinë e transferimit të vlerave të tyre në përqindje. Treguesit që tregojnë rezultatin në përqindje përbejnë shumicën e numrit të përgjithshëm të treguesve që raportohen me anën e këtij raporti (29 nga 49 tregues).

Raportet e viteve të kaluara kanë pasqyruar performancën e komunave në mënyrë jo shumë standarde, disa tregues kanë pasqyruar në mënyrë komulative dhe disa të tjerë në mënyrë vjetore punën e komunave. Ky është raporti i parë që performancën e komunave apo rezultatet e arritura i pasqyron vetëm për vitin 2015. Megjithatë, edhe pse është bërë një verifikim indirekt i të dhënave për një kohë të gjatë nëpërmjet komunave, nuk përjashtohet mundësia që ndonjë tregues të pasqyrojë performancën komulative për komunën përkatëse. Se raporti pasqyron vërtetë performancën vjetore të komunave tregojnë edhe rezultatet e performancës së komunave për vitin 2015. Gjatë analizës së të dhënave vërejmë së në përgjithësi vlerat e rezultateve në krahasim me raportet paraprake janë më të ulëta. Nëse krahasohet me mesatarën kumulative të viteve të kaluara 2012 deri 2014 (49.38%), performanca e përgjithshme e komunave në vitin 2015 shënon një zvoglim prej 4.59%. Kjo në parim nuk paraqet ulje të performancës në punën e komunave, por paraqet ndryshimin e metodologjisë së raportimit të të dhënave, duke mos përfshirë arritjet e viteve të kaluara në shumën totale ashtu si është bërë në raportet e vitit 2014 ose 2013.

Sipas këtij vlerësimi komunat kanë treguar performancë më të mirë në këto fusha/tregues: shërbime administrative (87.49%), në shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimit (80.51%), % e km të trotuareve të përfshira në planin komunal për pastrim veror dhe dimerorë është (62.60%), Përqindjen e rrugeve të përfshira në mirëmbajtjen dimërore (62.13%), trotuare të përfshira në mirëmbajtje verore/dimërore (63.31%), vendbanime të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave (55.32%), përqindja e pagesave të bëra për mbeturinat (60.58%), fshatrat të përfshira në transport publik (59.5%), Ekonomi familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave (56.33%), parqet me qasje në ujë të pijshëm (54.39%), vendbanime të cilat posedojnë sistem të kanalizimit (54.56%), pagesa e ujit (50.39%), vendndalime të autobusëve të shenjëzuara (46.36%), dhe aktvendime të ekzekutuara nga inspektioni i ndërtimit (47.52%). Ndërsa treguesit të cilët kanë treguar performancë më të ulët sesa mesatarja e vendit janë: Parkingjet me shenjëzime (49.24%), vendbanimet në sistemin e ujisjellësit (45.03%), përqindja e fshatrave të përfshira në transportin publik komunal është (44.17%) përqindja e faturimit të ujit të pijshëm (41.94%) Ekonomitë familjare të përfshira në sistemin e ujisjellësit (48.99%), ekonomitë familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit (39.72%), asfaltimi i rrugeve lokale (39.04%), përqindja e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit total (38.72%) rrugë të përfshira në planin e pastrimit (34.33%), planifikimi urban (31.11%), përqindja e kilometrave rrugë me ndriçim publik në zonën urbane (35.99%), përqindja e kilometrave të rrugeve të përfshira në planin komunal për pastrim (34.25%) përqindja e sipërfaqes për të cilën ekzistojnë planet rregulluese në hapësirë (33.90%), përqindja e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit në zonën rurale (27.91%), përqindja e parkingjeve publike të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara (23.74%), përqindja e km të trotuareve të renovuara (23.68%), përqindja e km rrugë me ndriçim total (22.09%), përqindja e km rrugë në zonën rurale (15.50%) performanca në trajtimin e kërkesave për banim/strehim (22%) dhe rrugë me trotuare (21.3%).

Gjithsej 18 komuna (më pak se gjysma) kanë treguar performancë mbi mesatarën e vendit prej 44.79%. Më të dalluarat janë: Shterpca (75.27%), Fushë Kosova (71.95%) Graçanica (62.48%), Mitrovica e Jugut (70.61%), Junik (68.45%), Gajkovë (65.53%), Shterpca (68.30%), Gjakova (62.75%) etj. Ndërsa 20 komuna (më shumë se gjysma) kanë arritur rezultate nën mesatarën e vendit. Më keq qëndrojnë: Novonbërda (12.84%), Viti (25.20%), Kamenicë (25.79%), Mamushë (28.83%) etj.

Ndërsa përformanca për treguesit që shprehen në sasi janë si në vijim: aktivitete komunale në rini, sport dhe kulturë 4339 (mesatarja 120.53 aktivitete), objekte për aktivitete kulturore-/rinore 27 (mesatarja 0.75 objekte), objekte sportive 49 (mesatarja 1.36 objekte), Numri i rasteve emergjente/fatkeqësi 10453 (mesatarja 298.66), numri intervenimeve 10051 (mesatarja 287.17), sipërfaqe parkut/sheshit për kokë banori në metër katror 27.27 (mesatare 0.78), numri i parkingjeve të shënjëzuara 641 (mesatarja 16.87), Numri i parkingjeve publike të shënjëzuara 619 (mesatarja 16.87), numri i vendparkimeve 116044 (mesatarja 42.51).

Qëllimi kryesor i raportit të performancës është matja e shkallës së performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe jo klasifikimi i komunave në këtë proces të rëndësishëm. Megjithatë raporti pasqyron edhe shkallën e performimit sipas komunave për secilën fushë dhe tregues. Efikasiteti dhe efektiviteti i performancës së komunave është relativisht vështirë i konstatueshëm për faktin sepse treguesit e performancës masin vetëm sasinë e punëve të kryera, pa i krahasuar me ndonjë standard apo me atë çfarë ka qenë e planifikuar të realizohet. Format i këtij raporti nuk pasqyron performancën e përshkallëzuar ndërmjet komunave të mëdha apo urbane me komunat e vogla apo rurale, apo pasqyrimin e performancës së tyre në raport me madhësinë e territorit apo të buxhetit e karakteristika tjera të ngjashme. Raporti do të jetë më informues kur krahasohen komunat me karakteristika të ngjashme dhe besojmë se në raportin e ardhshëm me sistemin e rishikuar do të krijohen mundësitë e krahasimit mbi këto baza. Në përputhje me këtë, në vazhdim mund t'i gjeni disa të dhëna themelore për karakteristikat e komunave të republikës së Kosovës.

2. Hyrje

Matja e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarët është pjesë e ciklit të sigurimit të cilësisë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve nga ana e komunave. Matja e performancës përfshinë dy dimensione kryesore: 1). Matja e brendshme nga ana e vetë drejtorive dhe komunës dhe 2). Matja e jashtme që bëhet nga MAPL në bazë të të dhënave të gjeneruara dhe të raportuara nga komunat përkatëse. Matja e brendshme bëhet nëpërmjet shumë instrumenteve, si nëpërmjet mbledhjes, po ashtu edhe nëpërmjet përpunimit të të dhënave nga sektorë të ndryshëm të komunës. Komuna mund ta hartojë një raport të vetin për matjen e brendshme të performancës, por ajo mund ta matë performancën e saj edhe nëpërmjet raportimit të jashtëm nga MAPL. Ndërkaq MAPL e matë performancën e përgjithshme dhe atë individuale të secilës komunë, sipas fushave përkatëse, nëpërmjet krahasimit të të dhënave me treguesit dhe me rezultatet e fushave përkatëse. MAPL e bën përpunimin objektiv të të dhënave të raportuara nga komunat dhe nxjerrë gjetjet e përparimit apo të përkeqësimit të performancës së komunave. Për të siguruar vlefshmërinë e të dhënave, MAPL bën verifikimin e të dhënave në komunat përkatëse. Në vitin 2015 është punuar shumë për të zbatuar metodologjinë standarde në procesin e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave nga komunat.

Komunat raportojnë të dhënat për *treguesit institucionalë - treguesit e matur nga zyrtarët komunalë, ndërsa MAPL në bashkëpunim me UNDP ka angazhuar një kompani profesionale, UBO Consulting, për të raportuar të dhënat përtreguesit që reflektojnë kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet komunale*. Pra raporti përmban rezultatet e performancës së komunave të raportuara nga vetë komunat, performancën e azhuritit të komunave të raportuara po ashtu nga vetë komunat nëpërmjet sistemit elektronik CSC dhe kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet e ofruara nga komunat, të raportuara në Mozaikun e Kosovës 2015, të prodhuar nga UNDP dhe MAPL në bashkëpunim me USAID.

3. Qëllimi

Me anën e matjes së performancës dhe të azhuritit të komunave të Republikës së Kosovës synohet të përcaktohet shkalla ekzistuese dhe trendi i përmirësimit apo i përkeqësimit të performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve në mënyrë efektive dhe efikase për qytetarët e komunës përkatëse, apo të komunave në përgjithësi. Përparësitë e shënuara dhe dobësitë shfaqura gjatë punës nëpërmjet ***krahasimit të shkallës aktuale të performancës dhe të azhuritit me ato të viteve të kaluara, si dhe të shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve***, për të matë në mënyrë sa më të saktë shkallën e performancës së komunave dhe identifikimin e nevojave për zhvillim dhe përmirësim të saj.

4. Përfutjesit

Njëri ndër qëllimet kryesore të raportit është përdorimi i rezultateve të performancës së komunave nga të gjitha palët e interesit që kanë të bëjnë me ofrimin e këtyre shërbimeve për qytetarët. Rezultatet e performancës po shfrytëzohen nga komunat për përmirësim të planifikimit, nëveçanti të planifikimit të buxhetit në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), ndërsa MAPL për përmirësimin e zhvillimit të politikave në funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Përveç këtyre, nga raporti përfitojnë edhe institucionet e tjera qendrore dhe lokale, duke përfshirë këtu shoqërinë civile dhe në veçanti qytetarët e komunave përkatëse.

5. Metodologjia e punës

E tërë puna është bazuar në Rregulloren e Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale (tani e tutje Rregulloren). Në këtë proces të rëndësishëm dhe mjaftë të ndjeshëm, janë përdorë metodat më praktike për matjen e performancës dhe të azhuritetit të komunave, si dhe të anketimit me qytetarët. Metoda kryesore ka qenë bashkërendimii drejtpërdrejtë, nëpërmjet sistemit elektronik CSC/CMS, të MAPL me të gjitha komunat përkatëse. Fillimisht është bërë informimi i kordinatorëve komunalë të performancës për mënyrën e funksionimit të sistemit dhe futjen e të dhënave në sistemin për menaxhimin e performancës komunale. Në përputhje me udhëzimet e Rregullorës, komunat i kanë futë të dhënat në sistem nga 01 janar deri më 15 janar 2016. Deri më 15 janar 2016 të dhënat i kanë dërguar 35 komuna, ndërsa 3 komuna: Zubin-Potoku, Leposaviqi dhe Zveçani, i kanë dërguar të dhënat në fillim të muajit qershor. Zveçani ka raportuar për të gjitha fushat, ndërsa Leposaviqi ka raportuar për 8 fusha dhe Zubin Potoku ka raportuar për 6 fusha.

Gjatë punës në MAPL janë përdorë edhe metodologji të tjera profesionale, si: mbledhja empirike e të dhënave, krahasimi (analiza), sistematizimi (kategorizimi), verifikimi dhe korrigjimi, nxjerrja e përfundimeve dhe raportimi.

Në përgjithësi ka pas probleme në mbledhjen e të dhënave të sakta për periudhën raportuese të kërkuar. Probleme janë hasur në funksionimin e sistemit elektronik CSC në Komunën e Podujevës, të Obiliqit, Prishtinës dhe të Vitisë, ndërsa kapacitetet e ulëta të sistemit në komunat e mëdha e kanë pamundësuar nxjerrjen e të dhënave për azhuritetin dhe janë përdorë metoda jostandarde të teknologjisë për nxjerrjen dhe raportimin e të dhënave. Besojmë se në të ardhmen këto probleme do të adresohen dhe do të evitohen me kohë. Gjithashtu, disa komuna për disa treguesi kanë futë të dhënat në sistem me gabime numerike dhe logjike dhe kemi qenë të detyruar që të kërkojmë nga komunat përsëri verifikimin e tyre. Edhe pse në masën më të madhe janë raportuar korrigjimet e kërkuara, prapë për disa shërbime janë hasur gabime logjike dhe numerike. Mesatarja e të dhënave të përpunuara është përdorë si standard i krahasimit të arritjes së performancës së komunave për vitin 2015. Në këtë vit vlerat e treguesve të cilët janë shënuar me numra nuk janë transferuar në përqindje për shkak të bazës së ulët të krahasimit dhe të pasqyrimin real të vlerave të treguesve me përqindje. Përfermanca e këtyre treguesve është pasqyruar vetëm me njësinë matëse të kërkuar në treguesin përkatës. Ndërkaq grupi i treguesve të cilët njësinë matëse e kanë përqindjen janë grupuar dhe janë pasqyruar në një grup të veçantë, në bazë të të cilëve është nxjerrë edhe mesatarja e performancës në shkallë vendi.

6. Struktura e raportit

Për ta pasqyruar më mirë përmbajtjen e raportit, lënda e trajtuar është e ndarë në pesë kapituj. Në kapitullin e parë flitet për ndërlidhjen ekzekutive dhe metodologjinë e përdorur në mbledhjen e të dhënave dhe hartimin e raportit. Në kapitullin e dytë janë dhënë vërejtjet hyrëse, qëllimi i raportit, struktura e raportit dhe përfituesit e raportit. Në kapitullin e tretë është përfshirë përmbajtja kryesore e raportit për matjen e performancës së komunave për 15 fushat e ofrimit të shërbimeve themelore. Në kapitullin e katërt janë përmbledhë të dhënat statistikore për azhuritetin dhe efikasitetin e administratës komunale. Në kapitullin e pestë janë përmbledhë të dhënat që flasin për ndikimin e performancës dhe të azhuritetit në punën e komunave në ofrimin cilësor të shërbimeve për qytetarët.

KAPITULLI II

1. Pasqyra e përgjithshme e performancës së komunave

Matja e performancës së komunave është një proces shumë i ndërlikuar. Këtë e bën edhe më të ndërlikuar fakti se mungojnë standardet për ofrimin e shërbimeve, apo mjetet përkatëse profesionale që e bëjnë matjen e performancës më objektive. Matjabazohet vetëm në tregues të cilët nuk janë të shkallëzuar për matjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Nxjerrja e përfundimeve për përmirësimin, apo përkeqësimin e performancës së komunave mund të kuptohet vetëm nëpërmjet krahasimit të të dhënave nga viti në vit. Me këtë lloj të matjes nuk mund ta vlerësojmë nëse komuna e ka ofruar shërbimin e caktuar në sasinë dhe cilësinë e nevojshme, apo jo. Megjithatë, me anën e këtij sistemi dhe të këtij raporti mund ta matim dhe ta kuptojmë trendin e ofrimit të shërbimeve, që janë në përgjegjësinë e komunave.


Me organizimin administrativ dhe territorial të Republikës së Kosovës, aktualisht ekzistojnë 38 komuna, 10 prej tyre janë me shumicë serbe, 1 me shumicë turke dhe 27 me shumicë shqiptare. Nëbazë të shënimeve zyrtare, prej 38 komunave, kanë raportuar gjithsej 35 komuna ndërsa Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveçani nuk kanë raportuar dhe për këtë arsye nuk përfshihen në vlerësim të performancës. Të dhënat janë raportuar nga komunat për 15 fusha të veçanta që hyjnë në grupin e kompetencave vetanake (shërbimet themelore).

Përpunimi i të dhënave ka treguar se komunat kanë treguar një shkallë mesatare të performancës në ofrimin e shërbimeve.


Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave është 44.79%. Kjo mesatare e performancës së komunave është nxjerrë nga rezultatet e treguesve të cilët tregojnë performancën e komunave në përqindje. Tregues që tregojnë performancën në përqindje janë gjithsej 29 nga 49 tregues sa ka gjithsej sistemi. Informatat për rezultatet e treguesve të tjerë të cilët shprehen në sasi gjithashtu janë përfshirë në raport në kuadër të secilës fushë por llogaritja e mesatares së tyre nuk mund të nxirret për arsye të natyrës së tyre të ndryshme. P.sh. numri i objekteve të ndërtuara gjatë vitit 2015 për qëllime të sportit/kulturës apo rinisë nuk mund të nxjerr mesatare të përbashkët me treguesin që paraqet numrin e intervenimeve në rastet e nevojës emergjente apo numrin e vend-parkimeve të ndërtuara gjatë vitit 2015.

Qëllimi kryesor i raportit të performancës është matja e shkallës së performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe jo klasifikimi i komunave në këtë proces të rëndësishëm. Megjithatë raporti pasqyron edhe shkallën e performimit sipas komunave për secilën fushë dhe tregues.

Graf.1 Mesatarja e performancës së komunave sipas fushave për indikatorët që tregojnë rezultatin në përqindje



Grafi 2. Mesatarja e performancës së secilës komunë sipas fushazve për insiktorët që tregojnë rezultatin në përqindje



2. Performanca e komunave sipas fushave përkatëse

Aktualisht SMPSHK bën matjen e 15 fushave të ndryshme themelore nga kompetencat vetanake të komunave. SMPSHK funksionon dhe siguron matjen e performancës në secilën fushëduke u bazuar në rezultatet dhe treguesit përkatës. Fushat themelore për të cilat bëhet matja e performancës së komunave janë: Shërbimet Administrative; Mirëqenie Sociale; Kulturë, Rini dhe Sport; Menaxhimi i Emergjencave Lokale; Planifikimi Urban; Parqet dhe sheshet; Rrugët; Trotualet; Transporti publik komunal; Parkingjet publike; Ndriçimi Publik; Furnizimi me ujë; Kanalizimi dhe higjiena publike; Grumbullimi i mbeturinave dhe Deponimi i mbeturinave të ngurta.

2.1. Pasqyrimi i të dhënave të raportuara


Prej 38 komunave, 35 komuna kanë raportuar sipas kohës së planifikuar me SMPSHK, ndërsa 3 komuna kanë raportuar pas afatit të përcaktuar me Rregulleren 02/2013 për Sistemin e Menaxhimit të Performances së Shërbimeve Komunale. Pasqyrimin e të dhënave i ka parapritë një fazë e përpunimit dhe e verifikimit të tyre nga ana e MAPL dhe komunave. Nga të dhënat e raportuara është krijuar baza elektronike e të dhënave, nga e cila pastaj është bërë përpunimi i tyre sipas fushave dhe treguesve përkatës. Prej 29 fushave të shërbimeve komunale, MAPL aktualisht matë performancën e komunave vetëm për 15 fusha dhe raporton performancën e komunave vetëm për 49 tregues përkatës. Në vazhdim po i pasqyrojmë të dhënat e përpunuara sipas fushave përkatëse.

2.1.1. Shërbimet administrative

Shërbimet administrative përfaqësojnë shtyllën kryesore të ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Edhe ashtu administrata përfaqëson drejtorinë më të madhe në kuadër të komunës, me 23% të burimeve njerëzore të përgjithshme të angazhuara në këtë drejtori. Raporti pasqyron performancën e komunave për një tregues: % e lëndëve të shqyrtuara brenda vitit 2015. Për matjen e këtij treguesi janë mbledhur dy lloje të dhënave: Numri i gjithëmbarshtëm i lëndëve dhe Numri i lëndëve të shqyrtuara brenda vitit 2015.

Matja e këtij treguesi është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 35 komuna. Mesatarja në nivel të vendit e performancës së komunave për këtë fushë është 87.48%, apo 1.37 më e madhe se në vitin 2014. Shumica e komunave (22) apo 62.85% kanë treguar performancë më të lartë se mesatarja e vendit. Komunat të cilat kanë shënuar performancë të lartë, të lëndëve të shqyrtuar janë: Hani Elezit, Viti, Shtime, Skenderaj, Kaçanik, Vushtrri, Obiliq. Tetë (13) komuna apo 37.14% prej tyre janë nën mesatarën e vendit. Komuna që ka performancë shumë të dobët është Novoërda me 18.37% të lëndëve të qortuara apo 259 lëndë të shqyrtuara brenda vitit 2015. Grupi i komunave që nuk kanë raportuar për këtë tregues janë: Leposaviqi dhe Zubin Potoku. Të dhënat për shërbimet administrative janë marrë nga sistemi për matjen e azhuritetit.

Të dhënat për secilën komunë dhe për secilin tregues mund t'i gjeni në shtojcën e këtij raporti.



Graf.3. Performanca e komunave për shërbimet administrative


2.1.2. Mirëqenia sociale

Përfaqësojnë fushën e cila ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve të qytetarëve të cilët kanë nevojë për ndihmën e institucioneve publike. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet pesë treguesve: 1) Numri i rasteve të personave me aftësi të kufizuar që janë të punësuar në institucione komunale; 2) Numri i kërkesave për banim/strehim të rasteve sociale dhe njerëzve në nevojë; 3) Numri i familjeve të vendosura në strehimore kolektive; 4) Numri i rasteve nën përkujdesje sociale dhe 5) Numri i ankesave për shërbimet sociale.

Matja e këtyre treguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 37 komuna. Numri i përgjithshëm i të punësuarve me aftësi të kufizuar për vitin 2015 në komuna është 14 persona. Prej 35 komunave që kanë raportuar, vetëm 9 komuna kanë punësuar persona me aftësi të kufizuar për vitin 2015, ndërsa 28 komuna apo 75.68% e tyre nuk kanë punësuar asnjë person me aftësi të kufizuar. Komunat që kanë më së shumti të punësuar janë: Juniku 1, Podujeve, 2 Suharke 2 dhe Zveçan 4 persona.

Gjatë vitit 2015 komunat kanë pranuar gjithsej 2031 kërkesa për banim/strehim. Secila komunë mesatarisht ka pranuar 54.89 kërkesa në vitin 2015. Numër më të madh të kërkesave kanë pas këto komuna: Gjilani (500), Graçanica (237), Ferizaj (147) dhe Skenderaj (102).

Komunat gjatë vitit 2015 kanë arritur të strehojnë gjithsej 289 familje apo 9.3% e kërkesave të përgjithshme për strehim. Komunat që kanë strehuar më së shumti familje janë: Kamenica (49), Graçanica (29), Prizreni (23). Gjithsej 23 komuna apo 62.16% prej tyre nuk kanë strehuar asnjë familje. Mesatarja e përgjithshme e numrit të familjeve të strehuara është 5.11 për secilën komunë. Shumica e komunave kanë strehuar më pak familje se mesatarja e vendit.




Graf.4. Performanca e komunave për shërbimet sociale - strehimi

Në bazë të skemës sociale të komunave, numri i përgjithshëm i rasteve nën përkujdesje sociale është 25171 apo 5282 më pak se në vitin 2014 (shih në shtojcë të këtij dokumenti rastet për secilën komunë). Numri më i madh i qytetarëve përfitues nga skema sociale janë në komunat: Podujeva (2718), Mitrovica (1836) dhe Prishtina (1600). Shumica e komunave apo 20 prej tyre kanë numër të rasteve nën përkujdesje sociale më pak se mesatarja e vendit.

Gjithsej 1141 ankesa u janë parashtruar komunave nga qytetarët për të shprehë pakënaqsinë e tyre ndaj ofrimit të shërbimeve sociale. Numri më i madh i të pakënaqurve me ofrimin e shërbimeve sociale janë qytetarët e komunës së Mitrovicës me 155 ankesa, të Skenderajt me 116 dhe të Malishevës me 110 ankesa.

Fig. 5. Performanca e komunave sipas treguesve social – numri i rasteve nën përkujdesje sociale.




2.1.3. Kulturë, rini dhe sport


Është fushë shumë e rëndësishme që komuna ju ofron qytetarëve të saj, duke pasur parasysh se pjesa zotëruese e popullsisë së Kosovës janë të rinj dhe kanë nevojë për ofrimin e këtyre shërbimeve. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet katër treguesve: 1) Gjithsej numri i aktiviteteve komunale në tri sektoret – kulturë, rini dhe sport; 2) Gjithsej objekte sportive në komunë; 3) Gjithsej objekte për aktivitete rinore në komunë; 4) Gjithsej objekte për aktivitete kulturore në komunë.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 36 komuna. Numri i përgjithshëm i aktiviteteve për kulturë, rini dhe sport në komuna për vitin 2015 është 4339 apo 116 aktivitete më shumë se në vitin 2014. Komunitat që kanë më së shumti aktivitete për sport, kulturë dhe rini janë: Ferizaj (660), Viti (514), Gjakova (507) dhe Fushë Kosova (442). Mesatarja e përgjithshme e numrit të aktiviteteve për rini, sport dhe kulturë është 120.53. Shumica e komunave kanë treguar performancë nën mesatarën e vendit.

Graf.6. Performanca e komunave për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive



Gjatë vitit 2015 komunat kanë ndërtuar gjithsej 49 objekte sportive apo 1.36 objekte sportive për secilën komunë. Më së shumti objekte sportive ka ndërtuar Komuna e Vitisë (5) dhe e Skenderajt (4). Komunat që kanë shënuar rënie të madhe të performancës në këtë tregues janë: Prishtina, Shtime, dhe Graçanica. Më shumë se gjysma e komunave (17 ose 47.22%) nuk kanë ndërtuar asnjë objekt sportiv në vitin 2015. Numri i përgjithshëm i objekteve për aktivitete rinore dhe kulturore në komuna është 27 apo 0.75 objekte për secilën komunë. Komunat që kanë ndërtuar më së shumti objekte për aktivitete rinore në vitin 2015 janë: Skenderaj (5), Mitrovica e Jugut (4) dhe Juniku (4). Ndërkaq më shumë se gjysma e komunave nuk kanë ndërtuar asnjë objekt për aktivitete kulturore dhe rinore. Komunat që kanë shënuar rënie të theksuar të performancës në këtë tregues janë: Prishtina, Gjakova, Prizreni, Ferizaj dhe Gjiilani.



Graf.7. performanca e komunave sipas treguesve për kulturë, rini dhe sport.


2.1.4. Menaxhimi i emergjencave lokale

Përparësi në ofrimin e shërbimeve nga ana e institucioneve publike është ofrimi i ndihmës për të mbrojtur jetën dhe pasurinë e qytetarëve në raste emergjente. Institucionet publike kanë themeluar struktura dhe mekanizma të veçantë për reagime të shpejta. Raporti pasqyron performancën e komunave për pesë tregues: 1) Numri rasteve emergjente - fatkeqësitë (zjarre, vërshime, tërmete); 2) Vlera e pasurisë së humbur gjatë rasteve emergjente në euro në vit; 3) Numri i rasteve emergjente, për të cilat ekipet është dashur të dalin menjëherë në vend të ngjarjes; 4) Koha totale vjetore për arritjen në vend të ngjarjes për të gjitha rastet emergjente në minuta; 5) Koha mesatare e nevojshme për të arritur në vendin e ngjarjes në minuta.

Matja e këtyre treguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 36 komuna. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se numri i përgjithshëm i rasteve emergjente në komuna është 10453 apo mesatarisht 298.66 raste emergjente për secilën komunë. Komunat me numër më të madh të popullsisë kanë pasur më shumë raste emergjente, si: Prishtina (1710), Gjakova (1044), Vushtrri (668) dhe Gjiilani (655), ndërsa komunat e vogla, si: Zveçan (3) Klllokoti (6), Ranillugu (16) dhe Parteshi (23) kanë pasur numër më të vogël të rasteve emergjente. Mesatarja në nivel të vendit për numrine rasteve emergjente në komuna është 298.66, apo 59

raste më shumë se në vitin 2014. Shumica e komunave (23) kanë pas numër më të vogël të rasteve emergjente se sa mesatarja e vendit.


Graf.8. Pasqyra raportit të dëmeve të shkaktuara në Euro



Gjatë vitit 2015 komunat nga fatkeqësitë kanë humbur pasuri në vlerë prej 6,905,026.31 apo 3,451,012.31. Euro më shumë se në vitin 2014. Shprehur në përqindje 50.02% më shumë. Më së shumti humbje ka pasur Komuna e Obiliqit (1,743,300 euro), e Gjakovës (976000 euro) dhe e Vushtrrisë (648536 euro). Përgjithsisht dëmi më i madh është shkaktuar në ato komuna ku kemi edhe numër të madh të fatkeqësive, por ka edhe një numër i konsideruar i komunave që kanë pësuar dëme të mëdha më me pak raste të fatkeqësive, si: Obiliqi, Ranillugu, Shtërpça, Deçani, Novobërda dhe Klllokoti. Në mungesë të fondeve për emergjencë në komuna nuk ka të dhëna për shkallën e kompensimit të dëmeve nga fatkeqësitë e pësuar. Mesatarja në nivel vendi e

dëmeve të shkaktuara është 209,243.22 Euro. Shumica e komunave (27) kanë pësuar humbje më pak se mesatarja e vendit.

Graf.9. Performanca e komunave në menaxhimin e emergjencave lokale



Megjithatë komunat i kanë ofruar shërbime qytetarëve me dërgimin e ekipeve emergjente në vendin e fatkeqësive. Numri i përgjithshëm i reagimeve të ekipeve emergjente në komuna ka qenë 10051 raste apo në 96.15% të rasteve emergjente. Krahësuar me vitin 2014 (85.34%) shkalla e reagimit apo performanca ka qenë 3.24% më e madhe në vitin 2015. Në përgjithësi numri i rasteve të reagimit ka qenë në përpjestim të drejt me numrin e rasteve emergjente, por ka edhe disa komuna të cilat kanë shkallë të ulët të reagimit krahasuar me mesataren e vendit,


si: Vushtrrija (nga 688 raste ka reaguar vetem në 488 raste), Mitrovica e Jugut (nga 401 rasti ka reaguar vetëm në 210 raste). Më së shumti raste të reagimit ka pasur Komuna e Prishtinës (1705 raste) ndërsa komuna që ka pas më së paku raste të reagimit të ekipeve emergjente është Klllokoti (6 rast). Mesatarja në nivel të vendit e numrit të reagimeve të ekipeve emergjente në komuna është 263.94 apo krahasuar me vitin 2014 (197.42) është 66.52 raste apo 25% më shumë. (shih graf.9)

Mesatarisht komunave iu kanë nevojit 5344.2 minuta që të reagojnë ndaj fatkeqësive të ndryshme në këtë vit. Komunitat në vitin 2015 kanë intervenuar për 2485.74 minuta më shumë se në vitin 2014 apo 42% kohë më shumë. Ndërkaq koha mesatare e nevojshme për arritje në vendin e ngjarjes për një intervenim ka qenë 15.20 minuta, afër 1.5 minuta më e shpejtë se në vitin 2014 (16.71). Matja individuale e performancës komunale për këtë tregues ka qenë e vështirë sepse nuk ka të dhëna për largësinë e ndodhjes së fatkeqësive, nga e cila varet koha mesatare e reagimit.

2.1.5. Planifikimi urban

Komunitat janë të ballafaquara me probleme të theksuara sa i përket planifikimit dhe rregullimit urban. Përmirësimi i performancës së komunave në këtë dimension është nevojë e rëndësishme e përmirësimit të jetës së qytetarëve. Shumica e komunave kanë miratuar planet e rregullimit urban, por kanë problem në zbatimin e tyre. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet tre treguesve: 1) Përqindja e sipërfaqes së tokës/zonës urbane për të cilën ekzistojnë planet rregulluese në ha; 2) % e aktvendimeve të ekzekutuara nga inspekcioni i ndërtimit; 3) % e kërkesave të shqyrtuara për leje ndërtimi.

Graf.10. Performanca e komunave në planifikimin e zonave urbane



Matja e këtyre treguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 37 komuna. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e sipërfaqes së zonës urbane në hektar në nivel të vendit që është e rregulluar me plane rregulluese është 33.90%. Shumica e komunave janë nën mesatarën e vendit për sa i përket përqindjes së sipërfaqes së zonës urbane

të rregulluar me plane rregulluese. Komunitat që kanë arritur ta rregullojnë tërë zonën urbane me plan rregullativ janë: Mamusha, Shtime dhe Klina, Leposavic, Graçanicë dhe Gjiilan, të cilat për këtë arsye performancën gjatë vitit 2015 e kanë 0%, ndërsa komunitat që e kanë rregulluar zonën urbane me plane rregullative mbi 50%, janë: Gjilani (73.23 %), Graçanica (72.09%), Dragashi (60 %), Gjakova (56.09 %) dhe Skenderaj (51.06%). Shih grafikun 10.

Komunitat kanë organizuar vizita inspektuese për zbatimin e planeve rregulluese gjatë procesit të ndërtimit të vendbanimeve dhe kanë nxjerrë vendime përkatëse për zbatimin e ligjit dhe planit rregullues. Komunitat jo vetëm që i kanë nxjerrë vendimet por edhe i kanë ekzekutuar ato për ta mbrojtur zonën urbane nga ndërtimet e kundërligjshme. Komunitat kanë treguar performancë të ndryshme në ekzekutimin e vendimeve të inspektionit të ndërtimit. Shkalla e zbatimit të vendimeve në nivel vendi apo mesatarja e zbatimit është 47.52%. Gjysma e komunitave apo 50% e tyre kanë treguar performancë mbi mesatarën e vendit në ekzekutimin e vendimeve të inspektionit të ndërtimit. Komunitat që i kanë ekzekutuar 100% vendimet e inspektionit të ndërtimit janë: Kaçaniku, Fushë Kosova, Klina, Shtërpca, Juniku, Klllokoti dhe Parteshi. Pra janë kryesisht komunitat e vogla që kanë probleme më të vogla me ndërtimet pa leje që i kanë zbatuar vendimet 100%. Probleme në zbatimin e vendimeve të inspektionit prej komunitave të mëdha janë: Gjakova, Gjilani, Mitrovica e Jugut dhe Prizreni.


Shkalla e shqyrtimit të kërkesave për leje të ndërtimit në nivel të vendit është 80.51%. Komunita e Glllogocit, e Dragashit, e Obiliqit, e Pejës, e Podujevës, e Prizrenit, e Shtimës, e Malishevës, e Hanit të Elezit, e Junikut dhe e Parteshit i kanë shqyrtuar 100% kërkesat e qytetarëve për leje të ndërtimit. Vetëm një numër i vogël i komunitave janë nën mesatarën e vendit të performancës për këtë tregues.

2.1.6. Parqet dhe sheshet

Mjediset e banimit kolektiv në zonat urbane duhet të jenë me hapësirë të nevojshme dhe të qasshme edhe për ujë të pijshëm. Përmirësimi i hapësirave të banimit urban është preokupim edhe i komunitave. Përmirësimi i performancës së komunitave në këtë dimension është nevojë e rëndësishme e përmirësimit të jetës së qytetarëve. MAPL raporton për performancën e komunitave në këtë fushë nëpërmjet dy treguesve: 1) Sipërfaqja e parkut/sheshit për kokë banori, në metër katror (m²); dhe 2) % e parqeve-shesheve komunale me qasje në ujë të pijshëm.


Matja e këtyre treguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 37 komunita. Në shkallë vendi, gjithsej 27.27 m² për kokë të banori, është rritë sipërfaqen e parqeve në vitin 2015. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e performancës në nivel të vendit e sipërfaqës së parqeve/shesheve për kokë të banorit për vitin 2015 është 0.78 m² për kokë banori. Shumica e komunitave (22) kanë më pak m² të parqeve/shesheve se sa mesatarja e vendit. Komunitat të cilat kanë numrin më të madh të sipërfaqeve të parqeve/shesheve në m² për kokë të banorit janë: Juniku (4.11), Ferizaj (2.22), Podujeva (1.8), Suhareka (1.6) dhe Parteshi (1.4). Gjithsej 4 komunita kanë treguar performancë 0 për këtë tregues apo për zgjerimin e sipërfaqeve të parqeve dhe shesheve. Të dhënat specifike për secilën komunitë mund t'i gjeni në shtojcën e këtij raporti.

Mesatarja e përgjithshme e përqindjes së sipërfaqës së parqeve/shesheve me qasje të ujit të pijshëm është 17.21% krahasuar me vitin 2014 (58.85%).

Graf.11. Performanca e komunave në zgjerimin e parqeve dhe shesheve

2.1.7. Rrugët

Përfaqësojnë ndër shtyllat kryesore të ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Rrugët janë arteriet kryesore të qytetarëve për veprimtari të ndryshme shoqërore dhe ekonomike në komunën përkatëse. Ofrimi i këtij shërbimi është i ndërlidhur edhe me nivelin qendror, pasi që rrugët lokale janë të lidhura dhe të ndërlidhura edhe me rrugët rajonale duke krijuar sistemin rrugor për veprimtari të ndryshme të qytetarëve. Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet tre tregues: 1) % e km të rrugëve, të përfshira në planin komunal për pastrim / fshirje / larje; 2) % e rrugëve lokale në komunë, që janë të asfaltuara dhe 3) % e km rrugë, të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve.

Graf. 12. Performanca e komunave për mirëmbajtjen e rrugëve

Matja e këtyre teguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 37 komuna. Në bazë të analizave të bëra kuptohet se 39.04% e rrugëve lokale janë të asfaltuara, që është edhe mesatarja e vendit. Prej tyre 34.25% e rrugëve lokale janë përfshi në planin komunal për pastrim, ndërsa 62.13 % e tyre janë të përfshira në mirëmbajtjen dimërore. Performanca e vitit 2015 është afër 10 % më e vogël se në vitin 2014. Në bazë të analizave të bëra (shih graf. 12),


tregon se një numër i komunave (14) i mirëmbajnë përqindjen më të madhe të rrugëve të asfaltuara, ndërsa një numri i vogël i tyre (13): Partesh, Suhrekë, Obiliq, Lipjan, Leposaviq etj. nuk i mirëmbajnë të gjitha rrugët e asfaltuara. Grupi tjetër i komunave (20) i kanë përfshi në mirëmbajtjen dimërore një përqindje të lartë të rrugëve të asfaltuara. Përderisa 10 komuna i mirëmbajnë 100% rrugët gjatë dimrit, Vitia, Mamusha, Partesh dhe Novobërdo nuk kanë plan për mirëmbajtjen e rrugëve.

2.1.8. Trotuaret

Me shtimin e veturave në komunikacion dhe me nevojën e zgjerimit të rrugëve në zonat urbane, hapësira e këmbësorëve gjithnjë e më shumë po zvogëlohet. Hapësira për ecje ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së njeriut në vendbanimin e tij. Komuna është e obliguar që t'u sigurojë hapësirë të nevojshme kombësorëve për veprimtarinë e tyre në vendbanimin e tyre, por edhe hapësira për ecje të lirë dhe vrapim. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet dy treguesve: 1)% e km të trotuareve të rregulluara dhe 2) % e km të trotuareve të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen (pastrim-fshirje) verore/dimërore.

Matja e këtyre treguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 37 komuna. Mesatarisht secila komunë ka ndërtuar 23.68 % të km rrugë me trotuare, që përfaqëson edhe mesatarën e vendit. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se vetëm 10 komuna kanë arritur të performojnë mbi mesatarën e vendit, apo kanë shkallë më të lartë të ndërtimit të trotuareve. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të trotuareve të rregulluara në km janë: Shterpca (100%), Partesh (100%), Gracanica (100%), Dragashi (82.76%), Mitrovica e Jugut (72%) dhe Juniku (54.29%), ndërsa 27 komuna kanë ndërtuar më pak se mesatarja e vendit apo më pak se 23.68% të km rrugë trotuare.

Më shumë se gjysma e trotuareve janë të përfshira në planin komunal për mirëmbajtje dhe pastrim veror dhe dimëror, apo mesatarisht 62.60 % të trotuareve janë të përfshira në planin për mirëmbajtje verore dhe dimërore. Numri më i vogël i komunave (13) i ka përfshi 100% gjatësinë e trotuareve në km në planin komunal për mirëmbajtje dimërore dhe verore. Vetëm komuna e Hanit të Elezit, Partesh dhe e Mitrovicës Veriore nuk i kanë përfshi trotuaret në planin e mirëmbajtjes gjatë dimrit dhe verës. Shumica e komunave ka treguar performancë mbi nivelin e mesatares së vendit prej 62.60 %.

Grafi. 13. Performanca e komunave sipas treguesve për trotuaret

2.1.9. Transporti publik komunal


Lëvizja e popullatës nga fshati në qytet e ka rritur nevojën e shtimit të kapaciteteve dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit për transport publik të qytetarëve në vendbanimet urbane, por edhe qytet - fshat. Transporti publik gjithnjë e më shumë po bëhet problem dhe sfidë e menaxhimit të kësaj fushe. Shtimi i madh i automjeteve në komunikacion e ka vështirësuar transportin publik të qytetarëve, duke krijuar kështu një fyt të ngushtë në ofrimin e këtyre shërbimeve. Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet dy treguesve: 1) % e fshatrave

të përfshirë në transportin publik komunal; 2) % e vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim.

Matja e këtyre teguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 37 komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e përqindjes së përfshirjes së fshatrave në transportin publik komunal është 44.17 %. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të përfshirjes së fshatrave në transportin publik komunal janë: Juniku (100%) Juniku mbulon të 3 vendbanimet në kuadër të komunës së vetë dhe 7 vendbanime të komunës së Gjakovës. Ndërsa Peja, Obiliqi, Glogoci mbulohen në shkallën 100%. Komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët të përfshirjes së fshatrave në transportin publik komunal janë: Klina, Kamenica, Leposaviq, Novobërde, Podujeva, Prishtina, Vitia, Vushtrria, Malisheva, Mamusha, Klllokoti, Graçanica dhe Parteshi (0.0%). Për këtë tregues, numri më i madh i komunave ka treguar performancë mbi mesatarën e vendit por është rritur numri i komunave të cilat nuk sigurojnë transportin publik komunal.

Mesatarja e përqindjes së vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim është 46.36 %. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim janë: Fushë-Kosova, Deçan, Mitrovica e Veriut, Hani i Elezit, Dragash, Shtërpca, Mamushë dhe Shtiimja (100%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët të vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim janë: Klina, Kamenica, Podujeva, Prishtina, Vitia, Vushtrria, Malisheva, Klllokoti, Parteshi, Ranilug, Graçanicë dhe Novobërdë (0.0%).

Numri më i madh i komunave ka treguar performancë nën mesatarën e vendit për këtë tregues). Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në shtojcën e këtij raporti.

Graf. 11. Performanca e komunave sipas treguesve për transportin publik lokal.**2.1.10. Parkingjet publike**

Krahas shtimit të automjeteve të qytetarëve, rritet edhe kërkesa dhe nevoja për ofrim të shërbimeve për parkimin e tyre. Hapësirat e panevojshme dhe shtimi i shpejtë i numrit të veturave të qytetarëve në zonat urbane e kanë sjellë komunën para vështirësive të theksuara në ofrimin e këtyre shërbimeve. Komunat kanë ndërmarrë masa të caktuara, por ende të pamjaftueshme në ofrimin e mundësive për parkim të veturave në parkingjet publike. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet pesë treguesve: 1) Numri total i parkingjeve publike (në rrugë dhe jashtë rrugëve); 2) Numri total i parkingjeve publike të shenjëzuara (në rrugë dhe jashtë rrugëve); 3) Numri total i vendparkimeve publike (në rrugë dhe

jashtë rrugëve); 4) % e parkingjeve publike me shenjëzim horizontal dhe vertikal; 5) % e parkingjeve publike me vendparkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.


Matja e këtyre teguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga 38 komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komuna është 886. Mesatarja e numrit të parkingjeve publike në komuna është 23.32. Komunat të cilat kanë numër më të madh të parkingjeve publike janë: Prizreni (371), Peja (220) Suharekë (33) dhe Shtime (30), ndërsa komunat të cilat kanë numër më të vogël të parkingjeve publike janë: Dragashi, Klina, Kamenica, Novobërdo, Obiliqi, Malishava, Hani i Elezit, Mamusha, Klllokoti, Parteshi dhe Mitrovica Veriore (0 parkingje), pastaj Mitrovica e Jugut, Graçanica dhe Podujeva (2), Deçani (3), Ranillug, Vushtrri dhe Glllogoci (4), Shtërpca dhe Prishtina (5).

